

Përshëndetje!

Në përgjigje të kërkesës suaj, dërguar pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit dhe protokolluar me nr.059/17, si Koordinator për të Drejtën e Informimit pranë këtij Institucioni, ju bëj me dije se:

- Informacioni që ju kërkoni në lidhje me Buxhetin e Vitit 2016 dhe 2017, gjendet i pasqyruar në faqen e web-it të Universitetit të Elbasanit, uniel.edu.al, në rubrikën Programi i Transparencës dhe në nënrubrikën Drejtoria Ekonomike.
- Këto materiale dhe të tjera në lidhje me transparencën financiare të Universitetit të Elbasanit, që janë vendosur me kohë në faqen tonë, janë në respekt të Ligjit nr.119, dt.18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Duke shpresuar se përgjigja jonë të ketë plotësuar qëllimin e kërkesës suaj, ju uroj ditë të mbarë!

Florenc Vavla
Koordinator për të Drejtën e Informimit në UE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

RELACION
MBI REALIZIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2015 DHE
BUXHETIN E VITIT 2016

Hyrje

Hartimi i buxhetit ka mbështetje në: Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ligjit nr. 147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në IAL”, i ndryshuar si dhe akte të tjera ligjore e n/ligjore dalë në zbatim.

1. Tregues të përgjithshëm

Disa tregues strukturorë, ekonomikë e financiarë, me të cilët paraqitet Universiteti, në hartimin e Buxhetit të vitit 2016

➤ Ciklet e studimit, organizimi i strukturave, numri i studentëve.

- Ciklet e studimit dhe programet.


Në UE për vitin akademik 2015 – 2016 procesi mësimor do të zhvillohet në këto sisteme e cikle studimi:

- ◇ me kohë të plotë
- ◇ me kohë të pjesshme
- ◇ Në Ciklin e studimit me kohë të plotë:
 - Cikli i parë i studimeve – Bachelor me 39 programe studimi
 - Cikli i dytë i studimeve:
 - o Master profesional – MP me 25 programe studimi,
 - o Master shkencor – MSH me 13 programe studimi
- ◇ Në Ciklin e studimit me kohë të pjesshme:
 - Cikli i parë i studimeve - Bachelor me 14 programe studimi
- ◇ Cikli i tretë i studimeve:
 - o Doktoraturë:
 - Albanologji me profil Gjuhësi
 - Albanologji me profil Histori

Programet e studimit me kohë të pjesshme në Ciklin e parë dhe Ciklin e dytë të studimeve për vitin akademik 2015 – 2016 janë në vazhdim për vitet e treta e lart, ndërsa në vitin e parë e të dytë të studimeve nuk janë të hapura.

Programe studimi në vitet 2005 - 2016

Nr	Emërtimi	Vitet							
		2005 - 2006	2008 - 2009	2010 - 2011	2011 - 2012	2012 - 2013	2013 - 2014	2014 - 2015	2015 - 2016
1	Koha e plotë - Bachelor	20	20	26	29	32	38	38	39
2	Koha pjesëshme - Bachelor	11	11	14	14	14	15	15	14
3	Koha e plotë - MP	0	9	14	21	23	27	25	25
4	Koha e pjesëshme - MP	0	0	0	3	9	14	14	0
5	Koha e plotë - MSH	0	0	4	9	12	17	16	13
6	Koha e plotë - Dr	0	0	0	2	2	2	2	2



- Organizimi i strukturave

Universiteti i ushtron funksionet e tij akademike dhe administrative i organizuar në:


A. Rektorati

- ◇ Rektor
- ◇ Zv/Rektor
- ◇ Kancelar
- ◇ Drejtori

B. Fakultetet

- ◇ Fakulteti i shkencave të natyrës,
- ◇ Fakulteti i shkencave humane,
- ◇ Fakulteti i shkencave të edukimit,
- ◇ Fakulteti ekonomik,
- ◇ Fakulteti i Shkencave Mjekësore teknike

Fakultetet në vite



C. Qendrat

- ◇ Qendra e medias dhe informimit studentor.
- ◇ Qendra e zhvillimit mjedisor.
- ◇ Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit Mjedisor e Diagnostikues.
- ◇ Qendra e studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike.
- ◇ Qendra për kërkim dhe zhvillim në Edukim.
- ◇ Qendra për kërkim dhe zhvillime ekonomike

- **Numri i studentëve**


Në UE do të studiojnë për vitin akademik **2015 – 2016** gjithsej **11,300** studentë nga të cilët:

- Në ciklin e parë të studimeve **8,557** studentë:
 - me kohë të plotë **7,345** studentë,
 - me kohë të pjesshme **1,212** studentë.
- Në ciklin e dytë të studimeve **3,173** studentë:
 - Master i profesional **1,965** studentë,
 - Master i profesional me kohë të plotë **1,965** studentë,
 - Master i shkencave **760** studentë.
- Në ciklin e tretë të studimeve **18** studentë:
 - Albanologji me profil Gjuhësi **10** studentë,
 - Albanologji me profil Histori **8** studentë.


Studentët sipas ndryshimeve në sistemet dhe ciklet e shkollimit

Sistemi shkollimit	vitet								
	1999 - 2000	2003 - 2004	2006 - 2007	2008 - 2009	2011- 2012	2012- 2013	2013- 2014	2014 - 2015	2015 - 2016
Cikli i parë : Koha e plotë	1,431	3,963	6,705	5,776	6,640	7,181	7,843	7,716	7,345
Korrespondenca	1,500	2,350	664	279	0	0	0	0	0
<i>Koha pjesshme</i>	0	1,070	4,352	2,135	3,768	4,188	3,540	2,334	1,212
Cikli i dytë: MP koha plotë				310	752	1,507	1,683	1,929	1,965
MP koha pjesshme					82	337	616	350	0
Master shkencor					333	576	739	692	760
Cikli i tretë: Doktoraturë					0	11	29	29	18
Totali i studentëve	2,931	7,383	11,721	8,500	11,575	13,800	14,450	13,050	11,300

Numri i studentëve sipas hapjes së sistemeve dhe cikleve të studimit




Studentë në vite




- **Personeli akademik dhe personeli ndihmës**

Në UE për vitin 2016 do të jenë 340 punonjës akademikë dhe jo akademikë




Nga numri i punonjësve efektivë të Universitetit, parashikohen 72 % punonjës akademikë dhe 28 % punonjës jo akademikë ose në raportin afërsisht 3: 1.

Nga punonjësit akademikë në vitin akademik 2015 – 2016, 57 % janë me tituj e grada dhe 43 % pa tituj e grada.




Vihet re rritje e % që zënë punonjësit akademik



me tituj e grada nga viti i

mëparshëm. Kjo për arsye të kualifikimeve të këtij kontingjenti. Kështu që për vitin akademik 2015 – 2016 do të ketë rritje të përqindjes që zënë punonjësit akademikë me tituj e grada pasi janë në proces kualifikimi shkencor. Një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë mbaruar Master dhe janë në proces doktoreture, sikurse gjatë rekrutimit të punonjësve të rinj, janë vlerësuar punonjës

akademikë të kualifikuar. Në strukturën organike të miratuar për vitin 2016 situata paraqitet e tillë 69% e punonjësve akademikë janë me tituj e grada dhe 31 % e tyre pa tituj e grada.



➤ **Ngarkesa mësimore**

Për vitin akademik 2015 – 2016 janë parashikuar për t'u realizuar 178,786 orë mësimore. Nga orët e parashikuara do të mbulohen me punonjësit akademikë efektivë 125,501 orë mësimore, ndërsa nga punonjësit akademikë të ftuar (të jashtëm) janë parashikuar 53,285 orë mësimore.

Për të mbuluar ngarkesën mësimore të llogaritur me normat e punonjësve akademikë efektivë, sipas udhëzimit në fuqi, duhen 761 punonjës akademikë, ndërsa për të mbuluar orët nga punonjësit akademik të jashtëm duhen 355 punonjës.

NUMRI I STUDENTEVE DHE NGARKESA MËSIMORE QË MBULON ÇDO FAKULTET - "VITI 2014 - 2015"

Nr	FAKULTETI	Numri i studentëve			Nr. P/Akademik			Realizimi i mësimdhënies normuar									Mbulimi me pedagog	
								Brendshëm			Jashtëm			Gjithsej				
		Dita	K_Pjessh	Gjithsej	Brend.	Jasht.	Gjithsej	Dita	K_Pjessh	Shuma	Dita	K_Pjessh	Shuma	Dita	K_Pjessh	Shuma	Të brend (Norma)	Mbi ngarkesa + jasht
1	FSHN	1,197	195	1,392	43	96	122	18,376	10,309	28,685	10,703	427	11,130	29,079	10,736	39,815	10,430	29,385
2	FE	2,887	536	3,423	36	90	122	17,996	6,617	24,613	7,991	349	8,340	25,987	6,966	32,953	10,100	22,853
3	FSHH	1,634	330	1,964	56	173	217	26,915	9,104	36,019	17,058	955	18,013	43,973	10,059	54,032	15,728	38,304
4	FSHE	2,795	1,311	4,106	47	100	130	22,805	17,895	40,700	10,701	598	11,299	33,506	18,493	51,999	12,340	39,659
5	FSHMT	1,853	312	2,165	24	88	106	12,739	5,702	18,441	11,884	447	12,331	24,623	6,149	30,772	5,410	25,362
	TOT	10,366	2,684	13,050	206	547	698	98,831	49,627	148,458	58,337	2,776	61,113	157,168	52,403	209,571	54,008	155,563


NUMRI I STUDENTEVE DHE NGARKESA MËSIMORE QË MBULON ÇDO FAKULTET - "VITI 2015 - 2016"

Nr	FAKULTETI	Numri i studentëve			Nr. P/Akademik			Mësimdhënia e normuar									Mbulimi me pedagog	
								Brendshëm			Jashtëm			Gjithsej				
		Dita	K_Pjessh	Gjithsej	Brend.	Jasht.	Gjithsej	Dita	K_Pjessh	Shuma	Dita	K_Pjessh	Shuma	Dita	K_Pjessh	Shuma	Të brend (Norma)	Mbi ngarkesa + jasht
1	FSHN	1,106	117	1,223	48	96	144	18,362	6,185	24,547	8,506	256	8,763	26,868	6,442	33,310	11,020	22,290
2	FE	2,550	246	2,796	47	90	137	17,984	3,037	21,021	4,970	160	5,130	22,954	3,197	26,151	11,010	15,141
3	FSHH	1,575	187	1,762	74	173	247	28,183	5,159	33,342	14,202	541	14,743	42,385	5,700	48,085	17,400	30,685
4	FSHE	2,762	492	3,254	50	100	150	22,241	6,716	28,957	10,869	224	11,093	33,110	6,940	40,051	11,900	28,151
5	FSHMT	2,095	170	2,265	26	88	114	14,526	3,107	17,633	13,313	244	13,556	27,839	3,350	31,189	6,240	24,949
	TOT	10,088	1,212	11,300	245	547	792	101,297	24,204	125,501	51,860	1,426	53,285	153,157	25,629	178,786	57,570	121,216

Norma mesatare e ngarkesës	235	orë mësimore	Orë të pa mbuluara nga stafi efektiv	51,860	orë mësimore
Norma e ngarkesës të jashtëm	150	orë mësimore	Orë mbi normë nga stafi efektiv	43,727	orë mësimore
% që mbulon stafi efektiv mbi normë	76	%	Numri i punonjësve efektiv koha plotë	652	punonjës
% që mbulon stafi efektiv gjithsej	70	%	Numri i punonjësve efektiv gjithsej	761	punonjës
% që mbulon stafi jashtëm	30	%	Numri i punonjësve të jashtëm	355	punonjës

➤ **Shtrirja dhe mjediset**

UE e ushtron veprimtarinë e tij mësimore pothuajse në të gjithë territorin e qytetit të Elbasanit, edhe në periferi të tij (Njësia Administrative Bradashesh).



Aktualisht UE ka në administrim (vlerë kontabël) 12 godina, për të cilat duhet të kryhen procedurat e kalimit në pronësi të universitetit nga MAS – i dhe regjistrimi i tyre në ZVRPP. Ky proces kërkon angazhimin e një grupi specialistësh për të bërë të mundur krijimin e dosjeve për çdo godinë.

Sipërfaqja e mjediseve mësimore për student sipas godinave paraqitet:

Fakultetet	Sipërfaqja m ²		Nr. Studentëve	Sipërfaqja m ² për student
	Gjithësej	mësimore		
<i>Godina e Korpusit Kryesor</i>	8786	5272	2966	3.0
<i>Godina e Fakultetit shk. Edukimit</i>	3024	1814	2867	1.1
<i>Godina e Bibliotekës</i>	1830			
<i>Godina e Fakultetit Ekonomik</i>	3398	2039	2940	1.2
<i>Godina e Laboratorit Shkencor</i>	1211	727		
<i>Godina e Fakultetit Shkencave Mjeksore e Teknike</i>	3647	2831	1837	2.0
<i>Rektorati</i>	1040			
Shuma	22936	11076	10610	2.2

2. Realizimi i buxhetit viti 2015

Për vitin 2015 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën **727,855** mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, ri – alokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit.

Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

BUXHETI I TOTAL I VITIT 2015 dhe Akordimi

Kap.	Emërtimi i programit	Të ardhura			Shpenzime		
		Plan	Akorduar	në %	Plani	fakt	në %
1	Buxheti i brendshëm	52,100	52,145	100.09	52,145	52,145	100.00
2	Financim i huaj	0	0	0.00	0	0	0.00
3	Kosto lokale	0	0	0.00	0	0	0.00
4	TVSH	0	0	0.00	0	0	0.00
5	Të ardhurat	0	0	0.00	0	0	0.00
6	Të ardhura jashtë limiti	448,000	378,848	84.56	378,848	338,074	89.24
7	Projekti të huaja	0	0	0.00	0	0	0.00
8	Grant	296,862	296,862	100.00	296,862	296,862	100.00
	Totali	796,962	727,855	91.33	727,855	687,081	94.40

- Granti konkurrues, transferta tek individët, kërkimi shkencor (buxheti i brendshëm) **52,145** mijë lekë,
- Projekti të huaja **0** lekë,
- Transferta të pakushtëzuara - Granti **296,862** mijë lekë,
- Transferta të kushtëzuara për shpenzime korente e investime (të ardhura të institucionit të vitit dhe të trashëguara) **378,848** mijë lekë.

Ndarë në artikuj dhe sipas realizimeve përkatëse treguesit e këtij buxheti janë në pasqyrat: “Ri - alokimi i planit BUXHETIT PER VITIN 2015”, “TË ARDHURAT PËR VITIN 2015 - fakti”, “REALIZIMI I BUXHETIT PER VITIN 2015 – fakti”

Rialokimi i planit BUXHETIT PER VITIN 2015

Nr.	Emërtimi	Artikulli	Financim i brendshëm (kapitulli 1)			Granti (kapitulli 8)			Të ardhura (kapitulli 6)			Total Buxheti		
			Plani fillestar	Rialokim +/-	Plani	Plani fillestar	Rialokim +/-	Plani	Plani fillestar	Rialokim +/-	Plani	Plani fillestar	Rialokim +/-	Plani
1	Pagat	600	0	0	0	255,000	0	255,000	202,743	8,272	211,015	457,743	8,272	466,015
-	Pagat	600	0	0	0	255,000	0	255,000	84,868	-4,674	80,194	339,868	-4,674	335,194
-	Honorare - oret	600			0	0	0	0	117,875	12,946	130,821	117,875	12,946	130,821
2	Sig. Shoqërore	601	0	0	0	39,862	0	39,862	17,970	-975	16,995	57,832	-975	56,857
3	Shpenzime operative	602	0	0	0	2,000	0	2,000	130,000	-10,000	120,000	132,000	-10,000	122,000
4	Transf. me jashtë	605	0	0	0	0	0	0	900	-400	500	900	-400	500
5	Transf. Individ	606	0	0	0	0	0	0	3,000	18,770	21,770	3,000	18,770	21,770
6	Transf. Bursa	606	52,100	45	52,145			0	0	0	0	52,100	45	52,145
7	Stud. Projekt.	230	0	0	0	0	0	0	1,660	0	1,660	1,660	0	1,660
8	Projekte të Huaja	230			0			0	0	0	0	0	0	0
9	Kërkimi shkencor		0	0	0	0	0	0	34,227	333	34,560	34,227	333	34,560
-	Kërkimi shkencor	230			0			0	9,234	-2,935	6,299	9,234	-2,935	6,299
-	Kërkimi shkencor	231			0			0	3,107	0	3,107	3,107	0	3,107
-	Kërkimi shkencor	602	0	0	0			0	21,886	3,268	25,154	21,886	3,268	25,154
10	Investime	231	0	0	0	0	0	0	41,500	0	41,500	41,500	0	41,500
-	Paisje	231	0	0	0	0	0	0	41,500	0	41,500	41,500	0	41,500
-	Rikonstruksione	231	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
-	Ndërtime të reja	231	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
11	Projekte të Huaja		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Totali		52,100	45	52,145	296,862	0	296,862	432,000	16,000	448,000	780,962	16,045	797,007

2.1. Hyrjet e fondeve

Hyrjet e fondeve për Universitetin për vitin 2015 të ndara sipas financimeve kanë qenë:

Granti konkurrues, transferta tek individët, kërkimi shkencor – buxheti i brendshëm: financimi i tij është realizuar 100.1 % në vlerën 52,145 mijë lekë. Ky fond përbëhet:

- Për financimin e investimeve 0 mijë lekë
- Për financimin e bursave të studentëve 52,145 mijë lekë
- Për Kërkimin shkencor financimi prej 0 lekë

Buxheti i brendshëm (Granti konkurrues, transferta tek individët) fillestar ishte 52,100 mijë lekë. Në Dhjetor u akordua shpërblim fund viti për studentë të ekselencës 45 mijë lekë. Grant për investime dhe Fond për Kërkimin shkencor nga AKTI nuk është akorduar.

Granti për shpenzime korente: financimi i tij është realizuar 100 % në vlerën 296,862 mijë lekë. Granti fillestar në fillim të vitit ishte 296,862 mijë lekë. Pas rialokimeve gjatë vitit nuk kemi ndryshime. Themi se realizimi i tij është 100% ndërkohë që akordimi i këtij fondi nuk është realizuar, sipas nevojave, pasi për pagesën e pagave deri në fund të vitit kërkohet edhe 55,156 mijë lekë.

Fondet të kushtëzuar – të ardhurat e UE - së: Të ardhurat janë realizuar 83 % në vlerën 371,840 mijë lekë. Këto të ardhura janë grumbulluar gjatë vitit deri në 31 dhjetor 2015 në vlerën 364,821 mijë lekë, ndërsa janë trashëguar nga viti 2014 në vlerën 7,019 mijë lekë.

TE ARDHURAT PER VITIN 2015 - fakti

Krijimi				
Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	%
A	Të ardhura të vitit	448,000	364,821	81.43
1	<i>Qira</i>	424	408	96.34
2	<i>Tarifa Shkollimi</i>	408,273	338,083	82.81
3	<i>Libreza diploma</i>	19,313	12,089	62.59
4	<i>Fotokopje vërtetime etj.</i>	4,000	4,460	111.50
5	<i>Tarifa për regjistrim</i>	9,367	7,887	84.19
6	<i>Konkurse pranimit</i>	800	630	78.75
7	<i>Kurse Pasuniversitare</i>	0	0	0.00
8	<i>Shërbime të ndryshme</i>	924	1,065	115.21
9	<i>Debitor</i>	4,900	199	4.06
B	Të ardhura të trashëguara	0	7,019	0.00
1	Trashëguar nga viti 2014	0	7,019	0.00
Totali		448,000	371,840	83.00

Plani i grumbullimit të të ardhurave dhe fakti i realizimit të tyre për vitin 2015 u bazua në:

- programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor),
- programet e studimit të ciklit të dytë (MP e MSH),
- numrin e studentëve për çdo program studimi, nivelin e tarifave të vendosura me VKM për çdo program studimi


Realizimi i këtij plani erdhi si rezultat:

- Grumbullimi i pjesës kryesore të tarifave të shkollimit të planifikuara për vitin 2015 në tetor – dhjetor 2014. Një pjesë e këtyre të ardhurave janë përdorur për shpenzimet e planifikuara për tu realizuar në vitin 2014, shpenzime të trashëguara si detyrime të viteve të mëparshme. Pjesa e papërdorur kanë kaluar si të ardhura të trashëguara për vitin 2015.

Në realizimin e të ardhurave kanë ndikuar edhe efekte në ulje:

- Rritja e rasteve të përjashtimeve nga pagesa e tarifës së shkollimit, në zbatim të VKM – ve për tarifën e shkollimit.
- Mos shlyerja e detyrimeve të tarifave të shkollimit nga një pjesë e konsiderueshme e studentëve.
- Mos hapja e disa programeve në MP e MSH për vitin e parë si rezultat i mos plotësimit të numrit minimal të regjistrimeve. Për këto programe është planifikuar realizimi i të ardhurave sipas kuotave të planifikuara për secilin prej tyre.
- Mos hapja e disa programeve në Bachelor me kohë të plotë për vitin e parë për shkak të numrit minimal të regjistrimeve.
- Mos hapja e disa programeve në Bachelor me kohë të pjesshme për vitin e parë.
- Numri i ulët i regjistrimeve në disa programe studimi. Për këto programe ishte planifikuar realizimi i të ardhurave sipas kuotave të planifikuara për secilin prej tyre.

Të ardhurat - viti 2015



Në zërat e të ardhurave peshën kryesore e zënë:


- tarifat e shkollimit rreth 92.7 % , grumbullimi i të cilave është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria ekonomike dhe fakultetet. Këto të ardhura përbëhen nga:
 - tarifa e shkollimit në sistemin me kohë të pjeshme me rreth 16.7 %,
 - tarifa e shkollimit në sistemin me kohë të plotë me rreth 41.4 %,
 - tarifa e shkollimit në Ciklin e dytë të studimeve me rreth 34.3 % nga e cila Master profesional 21.3 % ndërsa Master shkencor 13 %.
 - tarifa e shkollimit në Ciklin e tretë të studimeve me rreth 0.3 %
- Libreza e diploma me rreth 3.3 %,
- Taksë regjistrimi me rreth 2.2 %,
- Shërbime të ndryshme ndaj studentëve dhe të tretë-ve rreth 1.8 % .

Nga zbatimi i VKM – ve për këtë qëllim rezulton se një pjesë e konsideruesme e studentëve përfitojnë nga përjashtimi i pagesës pjesore ose të plotë i tarifës së shkollimit. Sipas aplikimeve të kryera nga studentët për këtë qëllim përfitimi i tyre është 20,676,498 lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Përrjashtimet nga tarifat e shkollimit									
Bachelor me kohë të pjesshme									
DEGA	I parë		I dytë		I tretë		I katërt		Vlera
	Tarifa	Nr st	Tarifa	Nr st	Tarifa	Nr st	Tarifa	Nr st	
Matematikë fizikë			30,375		29,205		28,080		0
Biologji kimi			46,440		44,640		42,916		0
Teknologji informacioni			37,980		36,495		35,100		0
Infermieri e përgjithshme			46,440		44,640		42,916		0
Administrim biznes			37,980		36,495		35,100		0
Informatikë ekonomike			37,980						0
Financë kontabilitet			37,980		36,495		35,100		0
Ekonomia dhe e drejta			37,980		36,495		35,100		0
Arsimi fillor			43,020		41,400		39,780		0
Arsimi parashkollorë			43,020		41,400		39,780		0
Edukatë qytetare			43,020		41,400		39,780		0
Punonjës social			43,020		41,400		39,780		0
Filozofi sociologji			43,020		41,400		39,780		0
Psikologji			43,020						0
Gjuhë letërsi			43,020		41,400		39,780		0
Histori gjeografi			43,020		41,400		39,780		0
Totali Koha pjesshme		0		0		0		0	0
Bachelor me kohë të plotë									
Deget e tjera	25,000	152	17,030	211	16,375	255			11,568,955
Ek turiz, Adm - ing, Fizio			16,375	45	15,746	22			1,083,287
Totali Koha plotë		152		256		277		0	12,652,242
Masterat profesional e shkencor									
	Tarifa	Nr st	Tarifa	Nr st	Tarifa	Nr st	Tarifa	Nr st	
Master profesional	90,000	88							3,960,000
Master shkencor	144,000	24							1,728,000
Master shkencor			64,896	36					2,336,256
Totali Master		112		36					8,024,256
Totali përrjashtimeve		264		292		277		0	20,676,498
Totali studentëve	833								

Të ardhurat janë çelur për përdorim sipas ndarjeve në Buxhetin e vitit 2015 për Universitetin, mbështetur në bazë të nevojës për shpenzim për çdo artikull dhe kontratave të lidhura e të realizuara në investime e shpenzime operative, si dhe për shpenzime të tjera korente.

SHPERNDARJA										
EMERTIM I	I TAKOJNE			PERDORIMI						
	TOTAL I	BUXHETI T	INSTITUCIONI T	Artikulli						
				Totali	600	601	602	605-606	230-231	
LIMITI										
Plan	399,754	42.4	399,712	378,848	194,555	20,995	131,954	16,060	15,283	
Fakt	399,754	398	399,356	338,074	180,716	17,171	109,905	14,998	15,283	
TË PA PERDORURA (P-F)				40,774						
TË PA ÇELURA (total - plan)				20,508						
TRASHËGOHEN për vitin 2016				61,283						



Siç shihet nga grafiku këto të ardhura janë përdorur:

- për investime 4.5 %,
- për studim projektive 0 %
- për kërkimin shkencor 4 %
- për paga e shpërblime 53.5 % - me termin shpërblime janë: pagesa e orëve mbi normë në sistemin me kohë të plotë, pagesa e orëve mësimore në sistemin me kohë të pjeshme, pagesa e pedagogëve të jashtëm.
- për sigurime shoqërore 5.1 %
- për shpenzime operative 28.5 %,
- për transfertat tek individët 4.4 % .

2.2. Shpenzimet

Gjatë vitit 2015 shpenzimet gjithsej janë realizuar 94.4 % e financimit vjetor.

- Sipas formave të financimit
 - Shpenzimet nga Granti konkurrues, transferata tek individët, kërkimi shkencor – Financimi i brendshëm kap.1 janë realizuar 100 %,
 - Shpenzimet nga Granti për shpenzime korente është realizuar 100 %.
 - Shpenzimet nga të ardhurat e institucionit janë realizuar 89.2 %.
- Sipas zërave të shpenzimit:
 - Shpenzimet për Paga e shpërblime 96.6 %
 - Shpenzimet për Sigurime shoqërore 93.7 %
 - Shpenzimet për Shpenzime operative 85 %
 - Shpenzimet për Kërkimi shkencor 74.3 % nga të cilat:
 - Buxheti 0 %
 - Të ardhurat 74.3 %
 - Shpenzimet për Investimet 100 %

Me i detajuar realizimi i buxhetit 2015 sipas formave të financimit dhe ndarjes së zërave të shpenzimeve paraqitet në tabelën “*REALIZIMI I BUXHETIT PER VITIN 2015 – fakti*”

➤ Paga e shpërblime – Artikulli 600

Pagat për vitin 2015 janë mbuluar kryesisht me fondet nga Granti për shpenzime korente në masën 58.5 % nga ky fond, ndërsa pjesa tjetër prej 41.5 % janë përballuar nga të ardhurat. Me këtë fond page janë përballuar ndryshimet e pagës sipas kualifikimit të punonjësve akademikë. Pjesën më të madhe në zërin paga e shpërblime nga të ardhurat e Universitetit e zë pagesa e honorareve për orët mësimore. Si rezultat i transferimit të kësaj pagese në vitin 2015 u realizua pagesa e orëve mësimore të zhvilluara në vitin 2013 – 2014 e kryesisht: pagesa mbi 30 % e orëve mbi normë të punonjësve akademikë efektivë, pas miratimit nga MAS, pagesa e orëve mësimore në sistemin me kohë të pjesshme, pagesa e orëve mësimore të kryera nga punonjësit akademikë të ftuar. Gjithashtu nga të ardhurat është paguar personeli akademik i brendshëm për orët e zhvilluara në sistemin me kohë të plotë deri në 70 % të normës vjetore të normuar, orët e zhvilluara në sistemin me kohë pjesshme për vitin akademik 2014 – 2015 si dhe orët e shvilluara nga personeli akademik i ftuar (pedagogë të jashtëm). Të dhënat më të detajuara rezultojnë si në tabelën “Pagesa e orëve mësimore për vitin 2014 - 2015”.

Pagesa e orëve mësimore për vitin 2014 - 2015			
Nr	Lloji shpenzimit	Orë	Lekë
-	Për orët mbi normë të realizuara deri 30% të tejkalimit	14,764	12,040
-	Për orët mbi normë nga 30% deri 70% të tejkalimit	15,815	13,068
1	Total Orë mbi normë të brendshëm	30,579	25,107
2	Total për orët në K_pjesshme të brendshëm	51,473	48,539
3	Total për orët nga punonjës të jashtëm k plotë	53,461	48,578
4	Total për orët nga punonjës të jashtëm k pjesshme	2,978	3,337
	Fondi gjithsej	138,491	125,560

➤ **Fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601**

Fondi për sigurime shoqërore është shpenzuar për likuidimin e detyrimeve që institucioni ka ndaj Degës së Sigurimeve Shoqërore, si kontribut për punonjësit e vet. Ky zë është realizuar në masën 100 % për fondin e planifikuar nga granti. Si rezultat i mos financimit të plotë nga Granti për mbulimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore është përdorur nga të ardhurat 17,171 mijë lekë për këtë qëllim. Gjithashtu nga të ardhurat është përballuar fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore i llogaritur për pagesat e kryera për pedagogët e jashtëm për orët mësimore që këta të fundit kanë zhvilluar për vitin akademik 2014 – 2015, detyrime këto të përcaktuara sipas rekomandimeve të DRT Elbasan.

➤ **Shpenzime operative – Artikulli 602**

Në shpenzimet operative, pjesa nga Granti është shpenzuar 100 %, ndërsa nga të ardhurat e institucionit është 84.7 %. Në total si shpenzim është kryer 85 %. Shpenzimet operative për vitin 2015, janë realizuar kryesisht për: ujë, energji, telefon, karburant, buletini shkencor, kancelari, furnizime të ndryshme materiale, rojet e godinave, lysterje godine, riparime të ndryshme pajisjesh, veprimtari pritje-përcjellje, udhëtim e hotel për ekspeditat etje. Rritje të ndjeshme tek shpenzimet operative kanë disa zëra të domosdoshëm që i shërbejnë procesit mësimor. Krahas kësaj, rritje të ndjeshme kanë pagesat për rojet, uji, telefoni fiks, karburanti për ngrohje etje. Në vitin 2015 në likuidimin e kreditorëve për shpenzimet operative nuk pati probleme në afatin e likuidimit. Kjo për arsye të grumbullimit të të ardhurave në mënyrë periodike. Mos realizimi i shpenzimeve operative të planifikuara ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të disa prokurimeve për shkak të anulimit të procedurave.

REALIZIMI I BUXHETIT PER VITIN 2015 – fakti 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Artikulli	Financim i brendshëm Kap 1,			Granti Kap 8			Të ardhura Kap 6			Total Buxheti		
			Plani	Fakt	%	Plani	Fakt	%	Plani	Fakt	%	Plani	Fakt	%
1	Pagat	600	0	0	0.0	255,000	255,000	100.0	194,555	180,716	92.9	449,555	435,716	96.9
-	Pagat	600	0	0	0.0	255,000	255,000	100.0	63,734	55,156	86.5	318,734	310,156	97.3
-	Honorare - oret	600	0	0	0.0	0	0	0.0	130,821	125,560	96.0	130,821	125,560	96.0
2	Sig. Shoqërore	601	0	0	0.0	39,862	39,862	100.0	20,995	17,171	81.8	60,857	57,033	93.7
3	Shpenzime operative	602	0	0	0.0	2,000	2,000	100.0	113,755	96,377	84.7	115,755	98,377	85.0
4	Transf. me jashtë	605	0	0	0.0	0	0	0.0	339	0	0.0	339	0	0.0
5	Transf. Individ	606	0	0	0.0	0	0	0.0	15,721	14,998	95.4	15,721	14,998	95.4
6	Transf. Bursa	606	52,145	52,145	100.0	0	0	0.0	0	0	0.0	52,145	52,145	100.0
7	Stud. Projekt.	230	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
8	Projekte të Huaja	230	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
9	Kërkimi shkencor		0	0	0.0	0	0	0.0	18,200	13,528	74.3	18,200	13,528	74.3
-	Kërkimi shkencor	230	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
-	Kërkimi shkencor	231	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
-	Kërkimi shkencor	602	0	0	0.0	0	0	0.0	18,200	13,528	74.3	18,200	13,528	74.3
10	Investime	231	0	0	0.0	0	0	0.0	15,283	15,283	100.0	15,283	15,283	100.0
-	Paisje	231	0	0	0.0	0	0	0.0	15,283	15,283	100.0	15,283	15,283	100.0
-	Rikonstruksione	231	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
-	Ndërtime të reja	231	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
	Totali		52,145	52,145	100.0	296,862	296,862	100.0	378,848	338,074	89.2	727,855	687,081	94.4

Rialokimi i planit BUXHETIT PER VITIN 2015 date 31.07.2015

Nr.	Emërtimi	Artikulli	Financim i brendshëm (kapitulli 1)			Granti (kapitulli 8)			Të ardhura (kapitulli 6)			Total Buxheti		
			Plani fillestar	Rialokim +/-	Plani	Plani fillestar	Rialokim +/-	Plani	Plani fillestar	Rialokim +/-	Plani	Plani fillestar	Rialokim +/-	Plani
			1	Pagat	600	0	0	0	255,000	0	255,000	202,743	8,272	211,015
-	Pagat	600	0	0	0	255,000	0	255,000	84,868	-4,674	80,194	339,868	-4,674	335,194
-	Honorare - oret	600			0	0	0	0	117,875	12,946	130,821	117,875	12,946	130,821
2	Sig. Shoqërore	601	0	0	0	39,862	0	39,862	17,970	-975	16,995	57,832	-975	56,857
3	Shpenzime operative	602	0	0	0	2,000	0	2,000	130,000	10,000	120,000	132,000	-10,000	122,000
4	Transf. me jashtë	605	0	0	0	0	0	0	900	-400	500	900	-400	500
5	Transf. Individ	606	0	0	0	0	0	0	3,000	18,770	21,770	3,000	18,770	21,770
6	Transf. Bursa	606	52,100	3,400	55,500			0	0	0	0	52,100	3,400	55,500
7	Stud. Projekt.	230	0	0	0	0	0	0	1,660	0	1,660	1,660	0	1,660
8	Projekte të Huaja	230			0			0	0	0	0	0	0	0
9	Kërkimi shkencor		0	0	0	0	0	0	34,227	333	34,560	34,227	333	34,560
-	Kërkimi shkencor	230			0			0	9,234	-2,935	6,299	9,234	-2,935	6,299
-	Kërkimi shkencor	231			0			0	3,107	0	3,107	3,107	0	3,107
-	Kërkimi shkencor	602	0	0	0			0	21,886	3,268	25,154	21,886	3,268	25,154
10	Investime	231	0	0	0	0	0	0	41,500	0	41,500	41,500	0	41,500
-	Paisje	231	0	0	0	0	0	0	41,500	0	41,500	41,500	0	41,500
-	Rikonstruksione	231	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
-	Ndërtime të reja	231	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
11	Projekti Çilesi Barazi		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Totali		52,100	3,400	55,500	296,862	0	296,862	432,000	16,000	448,000	780,962	19,400	800,362

➤ **Shpenzime operative për transferta me jashtë – Artikulli 605**

Transferta me jashtë nuk është realizuar. Ky shpenzim është planifikuar për pagesën e pjesëmarrjes në një projekt ndërkombëtar, për të cilin nuk pati kërkesa nga njësitë bazë.

➤ **Transferta tek individët – Artikulli 606**

Shpenzimet për transferta tek individët janë realizuar 100 % të fondit të akorduar. Ky fond ndahet:

- **Transferta tek individët (nga granti)** në fondin prej 45 mijë. Me këtë fond janë shpërblyer në fund të vitit 9 studentë të ekselencës.
- **Transferrat për rastet e fatkeqësive dhe ndihmës ndaj punonjësve.** Në vitin 2015 janë kryer disa pagesa për raste fatkeqësie për vlerën 383 mijë lekë, për shpërblimin e punonjësve të UE që kanë dalë në pension për vlerën 241.98 mijë lekë dhe shpërblim page me vendim gjyqi për vlerën 949.102 mijë lekë. Ky fond është marrë nga fondi i veçantë pjesë e fondit të pagave dhe ka kaluar në këtë artikull rast pas rasti. Gjithashtu janë rimbursuar studentët që kanë paguar tarifën e shkollimit për të cilën është reduktuar tërësisht ose pjesërisht sipas akteve ligjore. Për këtë qëllim janë përdorur 13,414 mijë lekë.
- **Bursat e studentëve.** Për vitin 2015 fondi i bursave të studentëve është realizuar 100 % e fondit të akorduar. Ky fond duhet të përballonte pagesën e bursave të studentëve për muajt Tetor 2014 – Qershor 2015 për të tre vitet e Ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë dhe Tetor 2015 – Dhjetor 2015 për vitet e dyta e të treta. Fondi i akorduar për bursat e studentëve në fillim të vitit ishte në vlerën 52,145 mijë lekë dhe i ndarë me limit përdorimi mujor në mënyrë të tillë që nuk mund të paguheshin në muajin korent bursat. Gjithashtu ky fond nuk qe i mjaftueshëm për pagesën e plotë të bursave në muajin qershor për studentët e vitit akademik 2014 – 2015. Pas rialokimit të Buxhetit të Shtetit u akorduan shtesa me vlerë 6,350 mijë lekë. Me fondin e shpenzuar nuk është përballuar pagesa e plotë për muajt tetor 2015 – dhjetor 2015 për studentët e viteve të dyta e të treta. Për këtë kontigjent është kryer pagesa për muajin tetor dhjetëditëshi i tretë dhe pjesërisht muaji nëntor. Nga mungesa e fondeve për kryerjen e plotë të pagesës brenda vitit 2015 do të ketë probleme në vitin 2016.

Bursat 2014 - 2015		
Vitet	Nr. Student	Bursa të plota
Vitet I	363	211.5
Vitet II	310	240.5
Vitet III	301	240.5
Shuma	974	692.5

➤ **Studime e projektme – Artikulli 230**

Në këtë zë për vitin 2015 nuk janë planifikuar shpenzime

➤ **Investime – Artikulli 231**

Treguesit në tabelën e mëposhtme japin informacion mbi realizimin e fondeve për investime. Këto fonde janë realizuar në total 35.4 % të fondit të planifikuar nga të ardhurat.

Realizimi i fondit për investime viti 2015				
Nr.	Objekti i prokurimeve	Plani 2015	Realizimi fondit	
		000/ lekë	000/ lekë	%
A	Të ardhura	43,160	15,283	35.4
I	Studime e projektme	1,660	0	0.0
II	Rikonstruksione	0	0	0.0
III	Pajisje	41,500	15,283	36.8
B	Granti konkurues	0	0	0.0
I	Rikonstruksione	0	0	0.0
	Shuma	43,160	15,283	35.4

Totali i investimeve është në zërin paisje, kryesisht paisje kompjuterike, fotokopje si dhe shpenzime për krijim fondi biblioteke.

Mosrealizimi i objekteve të planifikuara për investime nga të ardhurat për studim projektme dhe për pajisje ka ardhur si rezultat i procedurave të prokurimit. Për këto objekte procedurat janë kryer në vitin 2015 dhe kontratat për këto investime do të lidhen në vitin 2016

➤ **Fondet dhe projektet për kërkimin shkencor**

Për këtë vit për kërkimin shkencor ishte menduar që të praktikohen dy format e financimit:

- Fondi për kërkimin shkencor me Grant konkurrues.
- Fondi për kërkimin shkencor nga të ardhurat.
- Fondi për kërkimin shkencor me Grant konkurrues. Ky fond financohet pas aplikimit për konkurrim pranë AKTI – t. Projektet u dërguan për konkurrim këtë vit , por nuk pati financime. Për objektet e dërguara për konkurrim, nga AKTI nuk erdhi konfirmim për miratimin e tyre.
- Fondi për kërkim shkencor nga të ardhurat. Për vitin 2015 UE kishte planifikuar fondin për kërkimin nga të ardhurat e tij me vlerë **34,560** mijë lekë. Ky fond do të përdorej për projektet e kërkimit shkencor në vazhdimësi dhe projekte të tjera të paraqitura në Rektorat në afatet e përcaktuara. Për vitin 2015 kryesisht u realizuan projektet kërkimore në kuadrin e konferencave të ndryshme , si dhe mirëmbajtja e sistemit EMS. Fondi i realizuar për këtë qëllim ishte 13,528 mijë lekë

Objektet e investimeve viti 2015"										
Nr.	Objekti i prokurimeve	Plani 2015	Vlera				Likujduar			pa likujduar
			Kontrata	Realizuar deri 2015		Gjithsej	Viti 2015		000/ lekë	
				000/ lekë	000/ lekë		%	000/ lekë		
A	Të ardhura	43,160	15,283	15,283	100.00	15,283	15,283	35	0	
I	Studime e projekte	1,660	0	0	0.00	0	0	0	0	
1	Projekt + preventiv "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor"	480							0	
2	Projekt + preventiv "Rikonstruksion amfiteatri Korpusi kryesor dhe fakulteti ekonomik"	480							0	
3	Projekt + preventiv "Rikonstruksion laboratorit Kërkimor FSHN"	700							0	
II	Ndërtime të reja	0	0	0	0.00	0	0	0	0	
								0		
III	Rikonstruksione	0	0	0	0.00	0	0	0	0	
					0.00	0		0	0	
IV	Pajisje	41,500	15,283	15,283	100.00	15,283	15,283	37	0	
1	Pajisje kompjuterike e fotokopje, U. Elbasan	19,000	0		0.00	0	0	0	0	
2	Pajisje e orendi për auditore laboratore e zyra, U. Elbasan	15,000	9,599	9,599	100.00	9,599	9,599	64	0	
3	Pajisje laboratorike, U. Elbasan	0	0		0.00	0	0	0	0	
4	Pajisje e audiovizive, U. Elbasan	6,000	5,587	5,587	100.00	5,587	5,587	93	0	
5	Fond libri, U. Elbasan	1,500	97	97	100.00	97	97	6	0	
V	Kërkim shkencor	0	0	0	0.00	0	0	0	0	
B	Granti konkurues	0	0	0	0.00	0	0	0	0	
		0	0	0	0.00	0	0	0	0	
			0					0	0	
	Shuma	43,160	15,283	15,283	100.00	15,283	15,283	35	0	

Projekte Kërkimi shkencor – UE viti 2015


Nr.	Emërtimi i projektit	Financimi 000/ lekë				
		Plani	Gjithsej	para 2015	2015	pas 2015
1	Ndërtimi i Database-s së Universitetit për menaxhimin e të dhënave -	12,000	10,584	0	6,174	4,410
2	Kërkim shkencor - projekte te ndryshme - 602	5,482	0	0	0	
3	Kostaq Cipo - Personalitet i gjuhësise shqiptare - Dr. Albert Riska	829	829	650	179	
4	Përdorimi i testeve ekotoksikologjike në hartimin e strategjive të përshtatshme të mbrojtjes së mjedisit	1,286	1,286	0	0	1,286
a	Përdorimi i testeve ekotoksikologjike në hartimin e strategjive të përshtatshme të mbrojtjes së mjedisit - 602	505	505	0	0	505
b	Përdorimi i testeve ekotoksikologjike në hartimin e strategjive të përshtatshme të mbrojtjes së mjedisit - 231	781	781	0	0	781
5	Joronim De Rada në 200 vjetorin e lindjes. Dr. Elvira Lumi - 602	1,400	1,169	869	300	
6	Përcaktimi I cilësive fiziko - kimike të tokave. - Prof. ass. Frederik Cane	709	709	709	0	709
a	Përcaktimi I cilësive fiziko - kimike të tokave. - Prof. ass. Frederik Cane - 602	326	326	0	0	326
b	Përcaktimi I cilësive fiziko - kimike të tokave. - Prof. ass. Frederik Cane - 231	383	383	0	0	383
7	Gramatika e gjuhës shqipe - Kostaq Cipo - Dr. Albert Riska Msc Teuta Toska - 602	700	700	0	463	
8	"Kërkime Arkeologjike e Gjuhësore në trevën e Bishqemit - Prof. ass. Ylli Cerova , Prof.ass. Albert Riska	2,573	2,573	0	0	2,573
a	"Kërkime Arkeologjike e Gjuhësore në trevën e Bishqemit - Prof. ass. Ylli Cerova , Prof.ass. Albert Riska - 602	1,150	1,150	0	0	1,150
b	"Kërkime Arkeologjike e Gjuhësore në trevën e Bishqemit - Prof. ass. Ylli Cerova , Prof.ass. Albert Riska - 231	1,423	1,423	0	0	1,423
9	"Kërkime Arkeologjike e Gjuhësore në trevën e Bishqemit - Prof. ass. Albert Riska, Prof. ass. Ylli Cerova	1,600	1,600	0	0	1,600
a	"Kërkime Arkeologjike e Gjuhësore në zonën e Funarit - Prof. ass. Albert Riska, Prof. ass. Ylli Cerova - 602	1,150	1,150	0	0	1,150
b	"Kërkime Arkeologjike e Gjuhësore në zonën e Funarit- Prof. ass. Albert Riska, Prof. ass. Ylli Cerova - 231	450	450	0	0	450
10	Konferenca Infermiore Kombëtare në Specialitete. - Skender Topi	700	686	0	686	0
11	Etiologjia,incidenca, faktorët e riskut dhe ndikimi i tyre ne patollogjite tumorale te aparatit treset dhe patologjia interne. - Skender Topi	1,936	1,934	0	1,934	0
12	Remzi Pernaska - Personalitet I Gjuhësisë Shqiptare - Teuta Toska	455	344	0	344	0
13	Bashkepunimi rajonal social ekonomik drejt tregjeve te zhvilluara - Marsida Ashiku	700	466	0	466	0
14	Letersia dhe media ne nje prespektive krahasuese - Elvira Lumi	800	798	0	498	300
15	Mehmet Çeliku- Personalitet I gjuhësise Shqiptare - Albert Riska , Teuta Toska	1,000	959	0	609	350
16	Ligji mbi transportin de lege ferenda 2015- Arbër Gjata	630	582	0	582	0
17	Progresi i së drejtës. Administrimi në fokusin e rregullimit të marrëdhënieve: Individ-Biznes-Shtet - Robert Gajda	320	221	0	221	0
18	Puna me studentët e edukimit fizik dhe orientimi për karrierën e tyre - Edmond Biçoku	200	104	0	104	0
19	Transporti publik: modele juridike – ekonomike drejt partneritetit publik – privat (PPP) - Shpëtim Çerri	540	297	0	297	0
20	Konferencë Ndërkombëtare - Informatika 2015 - Eljor Vila	700	673	0	673	0
	Shuma	34,560	26,513	2,228	13,529	11,228

➤ **Projektet e Huaja**

Për vitin 2015 ka patur rreth 5 projekte të huaja me bashkëfinancim , nga të cilat dy prej tyre janë realizuar , sipas parashikimit të shpenzimeve nga donatorët, një është në përfundim. Dy të tjerët, njëri nga të cilët është financuar nga donatorët dhe është në proces realizimi, ndërsa tjetri është në pritje për financim.

➤ **Financimet në vite**


Universiteti është financuar sipas dy formave: Financime të pakushtëzuara – granti dhe buxheti i shtetit, financime të kushtëzuara – të ardhurat e universitetit. Grafikisht paraqitet si më poshtë:



Sikurse vihet re ka një tendencë në rritje Financimi nga të ardhurat e universitetit, nga ku në katër vitet e fundit mbizotëron përqindja që zënë financimet e vetë universitetit, kundrejt financimit nga buxheti i shtetit.

Art	Emërtimi					Parash 2016
		2012	2013	2014	2015	
1	Fonde Kushtezuara UE	241,919	368,129	498,164	371,840	422,000
2	Grant , Buxhet	366,340	387,110	362,717	348,962	405,297
	Financim gjithsej	608,259	755,239	860,881	720,802	827,297

Art	Emërtimi					Parash 2016
		2012	2013	2014	2015	
1	Fonde Kushtezuara UE	39.8	48.7	57.9	51.6	51.0
2	Grant , Buxhet	60.2	51.3	42.1	48.4	49.0
	Financim gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0



3. Buxheti i vitit 2016

Hartimi i buxhetit të vitit 2016 është bazuar në projektet e paraqitura në periudhën e hartimit të p/buxhetit 2016 të miratuar, në ndryshimet e ndodhura pas miratimit të tij: strukturën organizative, programet e studimit, numrit të studentëve, në realizimin e buxhetit viti 2015, në nivelin e financimit nga Buxheti i Shtetit.

Financimi i buxhetit të vitit 2016 paraqitet si më poshtë:

Financimet për vitin 2016		
Nr	Emërtimi i projektit	Fondi në lekë
1	Granti për shpenzime korente, transfertat	405,297,000
2	Të ardhura të institucionit (Fondet të kushtëzuar)	422,000,000
TOTALI		780,962,000

Tërësia e financimeve dhe përdorimi i tyre për mbarëvajtjen e aktivitetit për të cilin funksionon Universiteti, përbën buxhetin e vitit 2016. Këtë buxhet po e paraqesim në mënyrë analitike si më poshtë:

3.1 Hyrjet e fondeve

Në hyrjet e fondeve për universitetin bëjnë pjesë: Granti për shpenzime korente, Granti konkurrues, Transfertat tek individët dhe të ardhurat e vetë institucionit, të cilat janë:

➤ Granti, Transferta - Fonde të pakushtëzuara

Granti + transfertat për vitin 2016		
Nr	Emërtimi i projektit	Fondi në lekë
1	Granti për shpenzime korente	347,197,000
2	Granti konkurrues (fondet për investime)	0
3	Fonde për transfertat tek individët (bursat)	58,100,000
TOTALI		405,297,000

Financimi nga Granti dhe transfertat për vitin 2016 është **405,297,000** lekë, me burime financimi:

- Granti për shpenzime korente për të mbuluar shpenzimet e aktivitetit kryesor të institucionit me vlerë 347,197,000 lekë
- Grant konkurrues. Ky fond nuk është akorduar, pasi lidhet me procedurat e konkurrimit dhe shpalljes fitues të projekteve të paraqitura për konkurrim.
- Fond për transfertat tek individët – bursat e studentëve me vlerë 58,100,000 lekë.

➤ **Të ardhura të institucionit**

Fonde të kushtëzuar - të ardhurat e institucionit për vitin 2016 janë 422,000,000 lekë. Në tabelën “TE ARDHURAT E INSTITUCIONIT PER VITIN 2016” paraqiten më të detajuara burimet e krijimit të tyre dhe përdorimi.

TE ARDHURAT E VETË INSTITUCIONIT PER VITIN 2016						
KRIJIMI			SHPERNDARJA			
Nr.	Emërtimi	Lekë	Emërtimi		Lekë	
1	Qera	424,000	Totali		422,000,000	
2	Bach. koha plotë	182,067,950	A. Përdorimi	Studim projektme	230	1,080,000
3	M. Profesional	86,612,000		K. shkencor - 230	230	5,000,000
4	M. Shkencor	60,422,400		K. shkencor - 231	231	3,036,600
5	Doktoraturë	1,249,200		K. shkencor - 602	602	22,709,400
6	Bach. koha pjesh.	52,709,395		Investime	231	59,776,000
7	Libreza Diploma etj.	18,313,000		Paga e shpërblime	600	162,159,000
8	Lëshim dokumenti	4,230,000		Sigurime shoqërore	601	12,969,000
9	Taksë regjstrimi	9,104,600		Shpenzime operative	602	133,000,000
10	Tarifa konkurimi	1,000,000		Transf. jashtë	605	500,000
11	Tjera - shërbime	967,455		Transf. tek individë	606	21,770,000
12	Pjesm. konferenca	4,900,000		B. Pa përdorur		0
				C. Trashëgohen		0
	TOTALI	422,000,000	D. Buxheti		0	


Shpërndarja (përdorimi) i të ardhurave mund të përmblihet në këto grupe kryesore

Grupimet kryesore të financimit nga të ardhurat		
Nr	Emërtimi i projektit	Fondi në lekë
1	Fondet të kushtëzuar për shpenzime korente	330,398,000
2	Fonde të kushtëzuara për investime	60,856,000
3	Fonde të kushtëzuara për projekte e kërkim shkencor	30,746,000
	TOTALI	432,000,000


Në llogaritjen e mbledhjes së tyre janë marrë parasysh të dhënat e parashikuara në p/buxhetin e vitit 2016, duke pasqyruar ndryshimet. Gjithashtu ndikim jep:

- ◇ Pagesa për kreditet e mbartura dhe llogaritja e tarifës për kreditet e mbartura me dyfishin e tarifës normale / kredit
- ◇ Shpërndarja librezave e diplomave. Në këto të ardhura, përveç rritjes së numrit të studentëve e të diplomuarve, ndikim ka dhe pagesa nga studenti për marrjen e diplomës. Kjo pagesë lidhet me emetimin e diplomave me cilësi më të lartë, elementeve të sigurisë të vendosur në të, suportit në të cilin do të vendoset diploma dhe dokumentacioni shoqërues i saj, formë që plotëson standardet e emetimit të diplomave.
- ◇ Të ardhurat nga dhëniet me qira të objekteve janë parashikuar për 3 ambiente, dy prej të cilëve barë kafe (të kontraktuar pa tregtim pije alkoolike) dhe një Librari Universitare, si dhe pagesat për mjediset që përdoren për kurset e gjuhëve të huaja që kryhen nga Ambasada Italiane.

Të ardhurat, viti 2016



Të ardhurat - viti 2016



Siç vihet re peshën kryesore të të ardhurave të institucionit e zënë të ardhurat nga tarifat e shkollimit afërsisht 90.8 %.

Në krahasim me realizimin e vitit 2015 të ardhurat janë në rritje, ndërsa me parashikimin në P/Buxhet 2016 – 2018 janë në ulje. Ulja vjen si rezultat:

- ◇ Ulja e numrit të studentëve në disa programe studimi.
- ◇ Mos hapja e disa programeve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë për vitin e parë.
- ◇ Reduktimi i tarifave të shkollimit, nga zbatimi i VKM – ve për këtë qëllim. Rezulton se një pjesë e konsideruesme e studentëve përfitojnë nga përjashtimi i pagesës pjesore ose të plotë i tarifës së shkollimit. Sipas aplikimeve të kryera nga studentët për këtë qëllim përfitimi i tyre është 21,613,210 lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Përjashtimet nga tarifat e shkollimit									
Bachelor me kohë të pjesshme									
DEGA	I parë		I dytë		I tretë		I katërt		Vlera
	Tarifa	Nr st	Tarifa	Nr st	Tarifa	Nr st	Tarifa	Nr st	
Bachelor me kohë të plotë									
Të gjitha deget	25,000	220	25,000	200					10,500,000
Deget e tjera					17,030	232			3,950,960
Ek turiz, Adm - ing, Fizio					16,375	62			1,015,250
Totali Koha plotë		220		200		294		0	15,466,210
Masterat profesional e shkencor									
	Tarifa	Nr st	Tarifa	Nr st	Tarifa	Nr st	Tarifa	Nr st	
Master profesional	90,000	95							4,275,000
Master shkencor	144,000	26							1,872,000
Totali Master		121		0					6,147,000
Totali përjashtimeve		341		200		294		0	21,613,210
Totali studentëve	835								


Në Universitetin “A. Xhuvani” kostoja e një studenti mbi bazën e të cilës referohet vendosja e tarifave të shkollimit që duhet të paguajë studenti rezulton më e lartë se Universitetet e tjera Rajonale. Për këtë mendojmë që në MAS të dërgohen për propozim tarifat e shkollimit si më poshtë:

- Në ciklin e parë të studimit me kohë të plotë:
 - Program i parë studimi;
 - Programet e mësuesisë: cikli i ulët, parashkollorë, matematikë fizikë tarifa 350 lekë/kredit ose 21,000 lekë/vit
 - Të gjitha programet e tjera tarifa 500 lekë/kredit ose 30,000 lekë/vit
 - Program i dytë studimi:
 - Programet e mësuesisë: cikli i ulët, parashkollorë, matematikë fizikë tarifa 1,000 lekë/kredit ose 60,000 lekë/vit
 - Të gjitha programet e tjera tarifa 1800 lekë/kredit ose 120,000 lekë/vit
- Në ciklin e dytë të studimit:
 - Niveli i studimit MP:
 - Programet e studimit për matematikë e fizikë tarifa 800 lekë/kredit ose 72,000 lekë gjithsej

- Programet e studimit për mësuesi tarifa 1000 lekë/kredit ose 90,000 lekë gjithsej
- Të gjitha programet e tjera tarifa 1200 lekë/kredit ose 108,000 lekë gjithsej
- Niveli i studimit MSH:
 - Programet e studimit për matematikë e zbatuar tarifa 750 lekë/kredit ose 90,000 lekë gjithsej
 - Të gjitha programet e tjera tarifa 1,500 lekë/kredit ose 180,000 lekë gjithsej
- Në ciklin e tretë të studimit:
 - Niveli Doktoraturë:
 - Të gjitha programet e studimit tarifa 11,400 lekë/kredit ose 684,000 lekë gjithsej.

Për një menaxhim më të mirë në grumbullimin e të ardhurave, sa i përket tarifave të shkollimit, është e rëndësishme vendosja e tarifave të njëjta (tarifë për kredit), me ndryshim vetëm nga cikli dhe sistemi i studimit. Kjo për faktin e anomalive të krijuara për shkak të shumëllojshmërisë së tarifave që aktualisht aplikohen në universitet – mbi 30 lloje tarifash shkollimi nga të cilat 21 lloj tarifash shkollimi janë në bachelor me kohë të plotë, për program të parë e të dytë studimi.

Analizat e tjera të të ardhurave: qira, programe mësimore, shërbime laborator etj. zënë një peshë të vogël në strukturën e të ardhurave, kjo për faktin e tarifave që aplikohen për këto shërbime.



3.2 Shpenzimet

Buxheti i shpenzimeve të vitit 2016 mbulohet nga të hyrat e fondeve në universitet: Granti për shpenzime korente, Granti konkurrues, Transferta, të ardhurat që krijon vetë institucioni, duke i ndarë sipas zërave të shpenzimeve buxhetore.

Për ndarjen e shpenzimeve sipas zërave në nivel tre shifrorë jemi nisur nga:

- Ndarja e tyre në p/buxhetin e vitit 2016 duke reflektuar ndryshimet e ndodhura deri më 31.12.2015;
- Në numrin e punonjësve e kualifikim të tyre, ndryshmet në strukturë, akteve ligjore për pagesat;
- Numrin e studentëve dhe orët mësimore të pagueshme për mbulimin e procesit mësimor;

BUXHETI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2016

Nr.	Emërtimi	Artik.	Grant	Transferta	Të ardhura institucionit	Total Buxheti
1	Pagat	600	300,000,000	0	162,159,000	462,159,000
2	Sig. Shoqërore	601	47,197,000	0	12,969,000	60,166,000
3	Shpenzime operative	602	0	0	133,000,000	133,000,000
4	Transf. me jashtë	605	0	0	500,000	500,000
5	Transf. individet	606	0	0	21,770,000	21,770,000
6	Transf. Bursa	606	0	58,100,000	0	58,100,000
7	Kërkimi shkencor	230 - 231	0	0	30,746,000	30,746,000
8	Investime	230 - 231	0	0	60,856,000	60,856,000
a	Stud. Projekt.	230	0	0	1,080,000	1,080,000
b	Investime trupëzuara	231	0	0	59,776,000	59,776,000
-	Paisje	231	0	0	45,000,000	45,000,000
-	Rikonstruksione	231	0	0	14,776,000	14,776,000
-	Ndërtime të reja	231	0	0	0	0
9	Projekti huaja	230 - 231	0	0	0	0
	<i>Totali</i>		347,197,000	58,100,000	422,000,000	827,297,000

➤ Paga e shpërblime – Artikulli 600

Universitetit i nevojitet fond page rreth 462,159 mijë lekë nga e cila për paga 346,662 mijë lekë mbështetur në llogaritjet, sipas ecurisë së numrit mesatar të punonjësve, ndryshimit të numrit të tyre dhe realizimit të pagave për vitin 2015. Në këtë fond është reflektuar mundësia e rritjes së pagave duke llogaritur rreth 5% të fondit vjetor të pagave. Në këtë fond përfshihet edhe fondi i veçantë, i planifikuar mbi fondin e pagave. Në fondin e pagave është marrë në konsideratë efekti i pagesës së orëve të punës mbi kohën normale, për t'i shërbyer procesit mësimor në sistemin me kohë të pjesshme dhe menaxhimin e tij, i cili zhvillohet jashtë kohës normale të punës – në ditët e shtuna e të diela.

Fondi i pagave gjithsej do të mbulohet nga Granti për shpenzime korente dhe nga të ardhurat e institucionit. Me fondin nga të ardhurat e institucionit prej 162,159 mijë lekë do të përballohet:

- Pagat e punonjësve në vlerën prej 46,662 mijë lekë.
- Shpërblime për orët e zhvilluara në procesin akademik nga punonjësit e brendshëm e të jashtëm në vlerën prej 115,497 mijë lekë.

Pagesa e orëve mësimore për vitin 2015 - 2016			
Nr	Lloji shpenzimit	Orë	000/ Lekë
-	Për orët mbi normë të realizuara deri 30% të tejkalimit	17,046	14,159
-	Për orët mbi normë nga 30% deri 70% të tejkalimit	22,728	18,878
1	Total Orë mbi normë të brendshëm	39,774	33,037
2	Total për orët në K_pjesshme të brendshëm	24,204	22,541
3	Total për orët nga punonjës të ftuar	51,860	58,614
4	Total për orët nga punonjës të jashtëm	1,426	1,305
	Fondi gjithsej	117,264	115,497

➤ **Sigurime shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601**

Fondi i llogaritur për sigurime shoqërore prej 60,166 mijë lekësh përballon nevojat deri në fund të vitit. Krahas efektit nga rritja e pagave, për llogaritjen e këtij fondi është parashikuar edhe mundësia e rritjes së nivelit maksimal të pagës për kontribut.

Fondi i sigurimeve shoqërore do të përballohet nga granti 47,197 mijë lekë dhe nga të ardhurat e institucionit 12,969 mijë lekë.

➤ **Shpenzime operative – Artikulli 602**

